



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 25, datë 24.03.2022

PËR

**AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË INTEGRUAR TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE NË “DREJTËSI”, TË UNIVERSITETIT TË
NEW YORK-UT NË TIRANË**

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit” dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 24.03.2022, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të integruar studimit të ciklit të dytë, Master i Shkencave në “Drejtësi”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Program i integruar studimi, Master i Shkencave në “Drejtësi”
- b) Cikli i studimit: Cikli i dytë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 939, datë 03.09.2009, përshtatur me shkresë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 6858/2 Prot., datë 06.05.2011
- d) Akreditimi periodik: Vendim i Bordit të Akreditimit Nr. 40, datë 31.05.2019
- e) Institucioni që e ofron: Universiteti i New York-ut në Tiranë
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Drejtësisë dhe Disiplinave Humane
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 5 vite / 10 semestra
- h) Kredite (ECTS): 300 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Gjuha e mësimdhënies: Anglisht

- k) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Universiteti i New York-ut në Tiranë
- l) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 7

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Raportin e vlerësimit dhe rezultatet e akreditimit periodik për këtë program studimi;
- h. Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të lëna në kuadër të akreditimit periodik;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimit gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit periodik të këtij programi studimi, ka qënë Pozitiv me rekomandime;
- f. Institucioni i ka përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi periodik;
- g. Brezi i fundit i studentëve të pranuar në këtë program studimi ka qënë në vitin akademik 2019 – 2020;
- h. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”* dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, deri në vitin akademik 2019-2022, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 - 1. Mungon një strategji e posaçme zhvillimi për fakultetin përgjegjës për këtë program studimi.
 - 2. Mungon një plan i detajuar për orientimin e personelit akademik drejt kërkimit shkencor, individual ose në grup.
 - 3. Mundësi të kufizuara për trajnimin profesional të personelit akademik.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,


VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e integruar të studimit Master i Shkencave në “Drejtësi”, të **Universitetit të New York-ut në Tiranë**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit vetëm për studentët e regjistruar deri në vitin akademik 2019-2020 dhe që aktualisht ndjekin këtë program studimi, deri në diplomimin e tyre.
3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ




Kryetare

ALEXANDER KOHLER




Anëtar

AYŞEN SAVAŞ SARGIN




Anëtar

TOMASZ JELENSKI



Anëtar

IRAJ HASHI




Anëtar

MAURICE OUDEJANS



Anëtar

LEA YPI




Anëtar

KITA SALLABANDA DIAZ




Anëtar

DARINKA PIQANI




Anëtar

DRITAN NAÇE



Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar